

VENDIM
Nr. 95, datë 6.10.2014

PËR KUALIFIKIMIN E IMPIANTIT PRODHUES TË SHOQËRISË KOMP.ENERGJI”
SHPK NGA HEC-ET HURDHAS 1”, “HURDHAS 2” DHE “HURDHAS 3”, ME FUQI
TOTALE
4.21 MW

Në mbështetje të neneve 8 pika 2, germa “l”, 9 dhe 39 të ligjit nr. 9072, datë 22.5.2003, “Për sektorin e energjisë elektrike”, të ndryshuar, nenit 3 pika 1 germa “P”, të ligjit nr. 138/2013, datë 2.2.2013, “Për burimet e energjisë së rino-vueshme”; nenit 9 pika 1 dhe pika 2 germa “a” të “Rregullave dhe procedurave të certifikimit të prodhimit të energjisë elektrike nga burimet e rinovueshme”, të miratuara me vendimin e Bordit të Komisionerëve nr. 9, datë 21.2.2007, Bordi i Komisionerëve, në mbledhjen e tij të datës 6.10.2014, pasi shqyrtoi aplikimin e paraqitur nga shoqëria “Komp. Energji” sh.p.k. për kualifikimin e impiantit prodhues nga HEC-et Hurdhas 1”, “Hurdhas 2” dhe “Hurdhas 3” me fuqi totale 4.21 MW,

konstatoi se:

Aplikimi i paraqitur nga shoqëria “Komp.Energji” sh.p.k., është plotësuar kon-form “Rregullave dhe procedurave të certifikimit të prodhimit të energjisë elektrike nga burimet e rinovueshme”, si më poshtë:

- Neni 7, pika 1 , gjerat “a”, “b”, “c”, “d”

Përshkrimi i përgjithshëm i centralit

Ky dokumentacion është dhënë i saktë dhe i plotë.

- Neni 7, pika 2, gjerat “a”, “b”, “c”, “d”

Dokumentacioni vijues grafik, korografia, planimetria e përgjithshme, skema funksionale etj.

Ky dokumentacion është paraqitur në mënyrë korrekte.

- Neni 7 pika 3, gjerat “a”, “b”, “c”

Përshkrimi i centralit

Ky dokumentacion është dhënë i saktë dhe i plotë.

Për gjithë sa më sipër cituar, Bordi i Komisionerëve të ERE-s,

VENDOSI:

1. Të kualifikojë impiantin prodhues të shoqërisë “Komp.Energji” sh.p.k., si burim i rinovueshëm energjie nga HEC-et “Hurdhas 1” me fuqi 1,71 MW, “Hurdhas 2” me fuqi 1,3 MW dhe “Hurdhas 3” me fuqi 1,2 MW , me fuqi totale 4.21 MW.

2. Ngarkohet Drejtoria e Licencimit dhe Monitorimit të Tregut të njoftojë aplikuesin lidhur me vendimin e Bordit të Komisionerëve të ERE-s.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

Ky vendim botohet në Fletoren Zyrtare.

KRYETARI
Petrit Ahmeti